

**RREGULLORE PËR PRINDËRIT/PËRFAQËSUESIT  
LIGJORË NË  
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR TEK NEHEMIAH GATEWAY  
ALBANIA**

2020 – xxxx NG TEAM

© Fondacioni Nehemiah Gateway Albania 2020

Versoni 12.10.2020

<b>Neni 1 Baza ligjore.....</b>	<b>3</b>
<b>Neni 2 Të drejtat e prindërit/përfaqësuesit ligjorë .....</b>	<b>3</b>
<b>Neni 3 Detyrat e prindërit/përfaqësuesit ligjorë .....</b>	<b>3</b>
<b>Neni 4 Këshilli i Prindërve të Klasës .....</b>	<b>4</b>
<b>Neni 5 Këshilli i Prindërve të Shkollës.....</b>	<b>4</b>
<b>Neni 6 Këshilli i Prindërve të Shkollës: Zgjedhjet .....</b>	<b>5</b>
<b>Neni 7 Këshilli i Prindërve të Shkollës: Mbledhjet dhe vendimet.....</b>	<b>5</b>
<b>Neni 8 Funksonet e anëtarëve të Këshillit të Prindërve të Shkollës .....</b>	<b>5</b>
<b>Neni 9 Publikimi i rregullores së brendshme për arsimin parauniversitar.....</b>	<b>6</b>
<b>Neni 10 Hyrja në fuqi.....</b>	<b>6</b>

Prindërit/përfaqësuesit ligjorë janë pjesë e procesit të arsimit të fëmijëve dhe në thelb ata janë përgjegjës kryesorë për edukimin. Përgjegjësia e tyre për edukimin e fëmijëve shkon përtej përgjegjësisë financiare. Prindërit/përfaqësuesit ligjorë marrin pjesë në ngjarjet e Shkollës dhe mbështesin formimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Ata kanë të drejtë të zgjidhen në organet përfaqësuese të prindërve. Prindërit/përfaqësuesit ligjorë kanë të drejtë t'ia parashtojnë kërkesat e tyre me shkrim drejtorisë së Shkollës dhe të kontribuojnë në realizimin e detyrave të shkollës dhe në mbarëvajtjen e punës mësimore - edukative.

### **Neni 1** **Baza ligjore**

1. Ligji 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë
2. Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 për Miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë
3. Urdhurat dhe udhëzimet e nxjerra nga Ministria përgjegjëse për arsimin
4. Rregullorja e Përgjithshme e arsimit parauniversitar tek Nehemiah Gateway Albania

### **Neni 2** **Të drejtat e prindërit/përfaqësuesit ligjorë**

1. Të informohet për legjislacionin në fuqi, kurrikulën, programet mësimore, për objektivat, rregullat dhe aktivitetet shkollore si dhe për kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit, procedurat e ankimimit, procedurat e zhdëmtimit, arritjet e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme, dhe të kërkojë përmbushjen e tyre sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqipëtar.
2. Të marrë informacion të qartë për zhvillimin e fëmijëve, për sjelljet e rezultatet në shkollë si dhe për masat disiplinore në rast shkeljesh të tyre nga nxënësi.
3. Të marrë këshilla e ndihmë për edukimin familjar të fëmijës dhe të propozojë përmirësime të shërbimit arsimor në nivel klase ose institucioni arsimor.
4. T'i kërkojnë drejtorit rishikimin e vendimit për përjashtim nga shkolla, jo më vonë se një javë nga dita e dhënies së vendimit.
5. Të kërkojnë takim me mësuesin kujdestar për të diskutuar probleme individuale, që kanë të bëjnë me fëmijën e tyre.
6. Të informohet nga drejtuesi i institucionit arsimor ose mësuesi kujdestar dhe të japë lejë me shkrim për veprimtari të nxënësit pas orarit mësimor ose veprimtari jashtëshkollore.
7. Të propozojë përmirësime të shërbimit arsimor në nivel klase ose institucioni arsimor.

### **Neni 3** **Detyrat e prindërit/përfaqësuesit ligjorë**

1. Të ndihmojë fëmijën e vet për plotësimin e detyrave të dhëna nga mësuesi dhe të kujdeset që fëmija të ndjekë rregullisht institucionin arsimor.
2. Të njoftojë mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës.
3. Të përgjigjet pozitivisht ndaj thirrjeve për takime e sqarime nga ana e HoC ose drejtorisë.
4. Të ruajë komunikim etik me mësuesit, me drejtorinë e shkollës si dhe përfaqësuesit e NG AL për të gjitha problemet që e shqetësojnë.
5. Të respektojë afatet e shlyerjes së detyrimeve financiare. Në rast të kundërt, shkolla merr masa disiplinore, që mund të çojnë deri në largimin e fëmijës nga shkolla. Ky rregull është i vlefshëm vetëm për rastet kur personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore/prindërit e paguajnë tarifën e shkollimit (përjashtohen, pra, rastet e sponsorizimit).
6. Të mos paraqitet në mjediset e shkollës gjatë procesit mësimor, por vetëm në ditët e caktuara nga mësuesi kujdestar dhe drejtoria sipas orarit të pritjes së afishuar në mjediset e shkollës, me përjashtim të rasteve kur vizita e tij është për qëllime mësimore, apo i ftuar.
7. Të zbatojë të gjitha detyrimet e tjera që përfshihen në Rregullat e Brendshme të shkollës.

8. Të marrë pjesë në kualifikimet që zhvillon shkolla.
9. Të dorëzojë, bashkë me kontratën, listën me personat që janë të autorizuar prej tij për të marrë fëmijën nga shkolla/ambjentet e kampusit.
10. Të mos fyejë, shpifë apo të bëjë propagandë kundër institucionit.

#### Neni 4

##### Këshilli i Prindërve të Klasës

1. Këshilli i prindërve të klasës jep ndihmesën në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për nxënësit e klasës. Këshilli i prindërve të klasës është organ këshillimor në nivel klase, i cili mbështet përparimin e punës mësimore – edukative në klasë. Ai mbështet mësuesin kujdestar.
2. Këshilli i prindërve të klasës përbëhet nga 3 persona, të cilët zgjidhen nga tërësia e prindërve të klasës në mbledhjen e parë të prindërve të çdo klase. Anëtarët e Këshillit të Klasës kanë të drejtë të zgjedhin Këshillin e Prindërve të Shkollës. Prindi, i cili është i punësuar si mësues në institucionin arsimor, nuk mund të zgjidhet në Këshillin e Prindërve të klasës.
3. Kryetar i këtij Këshilli zgjidhet njëri prej prindërve, i cili është njëkohësisht dhe anëtar i këtij Këshilli.
4. Këshilli i Prindërve të Klasës thirret nga Kryetari i Këshillit të Prindërve të Klasës dhe mblidhet të paktën një herë në dy muaj, sipas një tematikë të planifikuar prej tij ose me propozimin e mësuesit kujdestar. Ai mund të mblidhet, me nismën e tij, edhe më shpesh. Këshilli mund të mblidhet edhe kur kërkohet me shkrim nga 1/4 e prindërve të klasës. Takimet e Këshillit drejtohen nga kryetari i tij.
5. Mësuesi kujdestar i klasës duhet të marrë pjesë në takimet e Këshillit të Prindërve të Klasës.
6. Këshilli i Prindërve të Klasës kryen detyrat si më poshtë:
  - a) i propozon mësuesit kujdestar përmirësime në mbarëvajtjen e nxënësve të klasës;
  - b) dëgjon parashtrimet e mësuesit kujdestar dhe i ofron bashkëpunim;
  - c) komunikon me prindërit/përfaqësuesit ligjorë të nxënësve që rrezikojnë braktisjen e shkollës, ose mbetjen në klasë, ose që kryejnë shkelje të disiplinës.
7. Këshilli i Prindërve të Klasës nxit prindërit/përfaqësuesit ligjorë të nxënësve të japin ndihmesën e tyre vullnetare:
  - o për të punuar me nxënës me vështirësi në të nxënë;
  - o për të hartuar ose/dhe për të vënë në jetë lëndë ose module me zgjedhje;
  - o për të bashkëpunuar në projekte kurrikulare.
8. Këshilli i Prindërve të Klasës ka të drejtë të ftojë në mbledhjet e tij mësues të tjerë të klasës, nxënës nga qeveria e nxënësve, anëtarë të drejtorisë, të bordit, të këshillit të mësuesve dhe të këshillit të prindërve të shkollës.
9. Këshilli i Prindërve të Klasës raporton në mbledhjen e përgjithshme të prindërve/përfaqësuesve ligjorë të nxënësve të klasës, si rregull, dy herë gjatë vitit shkollor.

#### Neni 5

##### Këshilli i Prindërve të Shkollës

1. Këshilli i Prindërve të Shkollës është organ i përbërë nga përfaqësues të prindërve/përfaqësuesve ligjorë të nxënësve të institucionit arsimor.
2. Këshilli i Prindërve të Shkollës është organ këshillimor në nivel cikli shkollor, i cili mbështet përparimin e punës mësimore – edukative në klasë. Ai ngrihet për arsimin bazë dhe për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë dhe mbështet nëndrejtorin e ciklit përkatës si edhe Drejtorinë e Shkollës.
3. **Këshilli i Prindërve ka të drejtë:**
  - a) të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të nxënësve të institucionit;
  - b) të shprehë pikëpamjet dhe të organizojë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit të institucionit dhe të dëgjohe për këto pikëpamje;
  - c) të thërrasë mbledhjen e përgjithshme të prindërve/përfaqësuesve ligjorë.
2. **Këshilli i Prindërve të Shkollës ka për detyrë:**

- a) Të ndërmarrë nisma për ndihmesën e prindërve/përfaqësuesve ligjorë për mbarëvajtjen e institucionit dhe t'i realizojë ato në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës.
- b) Të organizojë takime të përbashkëta me Këshillat e Prindërve të Klasave.

#### **Neni 6**

##### **Këshilli i Prindërve të Shkollës: Zgjedhjet**

3. Zgjedhjet për Këshillin e Prindërve të Shkollës dhe për kryetarin e tij zhvillohen çdo vit në fillim të vitit shkollor.
4. Këshilli i Prindërve të Shkollës përbëhet nga 3 deri maksimumi 7 anëtarë, të cilët zgjidhen nga tërësia e anëtarëve të Këshillave të Klasës në mbledhjen e parë të prindërve të shkollës me organizim të Drejtorit.
5. Në mbledhjen e parë të Këshillit të Prindërve të Shkollës zgjidhet kryetari i tij me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të këshillit.
6. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Prindërve të Shkollës nuk duhet të jenë në konflikt interesi me drejtorinë e institucionit, nuk duhet të kenë precedentë penalë dhe të mos jenë në forumet drejtuese të partive politike.
7. Kryetari dhe anëtarët e këshillit të prindërve shkarkohen me shumicë të thjeshtë të votave të fshehta të anëtarëve për moskryerje të detyrës, ose kur mungon/jnë në më shumë se gjysmën e mbledhjeve.

#### **Neni 7**

##### **Këshilli i Prindërve të Shkollës: Mbledhjet dhe vendimet**

8. Këshilli i Prindërve të Shkollës mbledhet të paktën tri herë në vit. Mbledhje të tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të këshillit të prindërve ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Ai mund të mbledhet edhe kur kërkohet me shkrim nga 1/4 e prindërve të klasës.
9. Mbledhja e këshillit të prindërve zhvillohet kur merr pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të tij, përndryshe shtyhet.
10. Në mbledhjen e parë përcaktohen detyrat e anëtarëve të Këshillit të Prindërve të Shkollës
11. Takimet e Këshillit të Prindërve të Shkollës drejtohen nga kryetari i tij.
12. Nëndrejtori i ciklit përkatës ose Drejtori i Shkollës merr pjesë në takimet e Këshillit të Prindërve të Shkollës me ftesën e tyre.
13. Këshilli i prindërve i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari.
14. Në mbledhjet e këshillit të prindërve, kryetari ka të drejtë të ftojë anëtarë të këshillave të prindërve të klasave, persona të tjerë që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, drejtues dhe mësues të institucionit, përfaqësues të OJF-ve etj.
15. Veprimtaria e anëtarëve të këshillit të prindërve është vullnetare.

#### **Neni 8**

##### **Funksionet e anëtarëve të Këshillit të Prindërve të Shkollës**

1. Kryetari drejton veprimtarinë e Këshillit të Prindërve të Shkollës.
2. Një anëtar i këshillit të prindërve caktohet nga kryetari në rolin e sekretarit të Këshillit.
3. Sekretari kryen detyrat sa më poshtë:
  - a) Përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e Këshillit të Prindërve të Shkollës;
  - b) Mban procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit të Prindërve të Shkollës;
  - c) Lajmëron anëtarët e Këshillit të Prindërve të Shkollës dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;
  - d) Mban arkivin e Këshillit të Prindërve të Shkollës.
4. Drejtori i institucionit arsimor, në marrëdhëniet me Këshillin e Prindërve të Shkollës kryen detyrat sa më poshtë:
  - a) I dorëzon Kryetarit të Këshillit të Prindërve të Shkollës kopje të dokumenteve ligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e institucionit arsimor, të cilat i nevojiten për ushtrimin e detyrës së tij.

- b) Informon Këshillin e Prindërve të Shkollës për rezultatet e institucionit arsimor në provimet/vlerësimet kombëtare/ndërkombëtare apo olimpiadat, duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve;
- c) Informon Këshillin e Prindërve të Shkollës për raportet publike të provimeve/vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare, si dhe për çdo studim që krahason institucionit arsimor me institucionet e tjera arsimore.
- d) Organizon, të paktën një herë në vit, mbledhje të përbashkëta të Këshillit të Mësuesve me Këshillin e Prindërve të Shkollës.
- e) Siguron për Këshillin e Prindërve të Shkollës një mjedis për zhvillimin e takimeve të tij.

#### **Neni 9**

##### **Publikimi i rregullores së brendshme për arsimin parauniversitar**

1. Kjo Rregullore dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohet dhe të jetë e aksesueshme elektronikisht dhe në formë të shtypur, veçanërisht për personelin e shkollës dhe nxënësit.
2. Drejtoria është përgjegjëse për të garantuar publikimin dhe aksesimin e rregullores.

#### **Neni 10**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore për arsimin parauniversitar tek Nehemiah Gateway Albania dhe ndryshimet në të hyjnë në fuqi ditën që miratohet.

**Lëshuar nga:**

Elona Rira

\_\_\_\_\_  
Drejtoreshë e Shkollës Nehemia

Buçimas, më \_\_\_\_\_

**Miratuar nga:**

Herolinda Shkullaku

\_\_\_\_\_  
Drejtor Ekzekutiv NG Albania

Buçimas, më \_\_\_\_\_